



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETARI

Nr. 958 Prot

Shkodër, më 14.7 .2020

VENDIM


**“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ORGANIZIMIT DHE
FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË STREHIMIT NË BASHKINË SHKODËR”**

Nr 144 datë 14/7 /2020

Mbështetur në nenin 8, pika 2, neni 9 pika 1/1.1, gërma « b », neni 24 dhe 64 të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, VKM nr.384 datë 12.06.2019 “Për caktimin e dokumentacionit për të përfituar sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKB nr. 2, datë 22.01.2020 “Për miratimin e ngritjes, përbërjes dhe funksionimit të komisionit të strehimit“, Urdhër i kryetarit të bashkisë nr. 466, datë 18.06.2020 “Për përcaktimin e anëtarëve të komisionit të strehimit pranë Bashkisë Shkodër“,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore së organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Strehimit në Bashkinë Shkodër, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Komisioni i Strehimit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË
STREHIMIT

Neni 1

Objekti i Rregullores

Kjo rregullore ka për objekt krijimin e një kuadri rregullator të veprimtarisë së Komisionit të Strehimit, duke përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të komisionit për realizimin e funksioneve dhe kompetencave në referim të dispozitave ligjore.

Neni 2

Baza ligjore

Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore“ i ndryshuar, Ligji nr. 22/2018 “Për Strehimin Social“, VKM nr.384 datë 12.06.2019 “Për caktimin e dokumentacionit për të përfituar sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore“, VKB nr.2, datë 22.01.2020 “Për miratimin e ngritjes,përbërjes dhe funksionimit të komisionit të strehimit“, Urdhër i kryetarit të bashkisë nr.466,date 18.06.2020 ,Për përcaktimin e anëtarëve të komisionit te strehimit pranë bashkisë Shkoder‘

Neni 3

Qëllimi i rregullores

Kjo rregullore ka si qëllim, përmbushjen e detyrimeve ligjore për administrimin e programeve të strehimit social në mbështetje të nenit 2, pika 51, nenit 15, pika 5 e ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social“ përmes ushtrimit të detyrave kryesore që konsistojnë në verifikimin dhe vlerësimin e listes së përfituesve për programet e strehimit social që zbatohen dhe të sigurojë transparencën dhe efikasitetin e këtij procesi.

Neni 4

Fusha e zbatimit të rregullores

Kjo rregullore i shtrin efektet e saj per Komisionin e Strehimit të Bashkisë Shkodër, krijuar me VKB nr. 2, datë 22.01.2020 “Për miratimin e ngritjes, përbërjes dhe funksionimit të komisionit të strehimit,, Urdhër i kryetarit të bashkisë nr. 466, datë 18.06.2020 “Për përcaktimin e anëtarëve të komisionit te strehimit pranë bashkise Shkodër. ,,

Neni 5

Përbërja e Komisionit të Strehimit

1. Komisioni i Strehimit referuar VKB nr. 2, datë 22.01.2020, dhe Urdhër nr. 466, datë 18.06.2020 i kryetari të bashkisë “Për përcaktimin e anëtarëve të komisionit të strehimit pranë bashkisë Shkodër,, ka në përbërje të tij përfaqësues nga disa drejtori të Bashkisë si dhe përfaqësues të grupeve të interesit dhe kategorive të pafavorizuara që do të jenë përfitues të programeve të strehimit social.
2. Kryetari i Komisionit të Strehimit është nënkryetar i Bashkisë.
3. Zëvendës kryetar i Komisionit të Strehimit është titullari i Drejtorisë së shërbimeve sociale dhe strehimin në bashki.
4. Sekretari i Komisionit të strehimit caktohet një nga anëtarët e Komisionit në mbledhjen e parë të tij.
5. Kryetari i Komisionit të Strehimit, drejton mbledhjen e tij, drejton diskutimet dhe siguron zbatimin e ligjit dhe marrjen e vendimeve të drejta.
6. Në mungesë Kryetari zëvendësohet përkohësisht nga zëvendëskryetari.
7. Anëtarët e Komisionit të strehimit, emerohen me urdhër të kryetarit të Bashkisë.

Neni 6

Thirrja e mbledhjeve

1. Mbledhjet thirren nga Kryetari i Komisionit të Strehimit me kërkesë të strukturës përgjegjëse të strehimit në bashki, i cili cakton datën dhe orën e mbledhjes.
2. Çdo ndryshim në datën dhe kohën e vendosur për mbledhjet i njoftohet çdo anëtar i Komisionit të Strehimit, në mënyrë që ata të njihen me këto ndryshime.
3. Rendi i dites duhet të përfshijë ato çështje që i janë propozuar kryetarit, nga struktura përgjegjëse e strehimit në bashki, si dhe çështje të propozuara nga vetë kryetari ose nga shumica e anëtarëve të komisionit dhe që janë në kompetencë të këtij komisioni.
4. Mbledhja e Komisionit është e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij (50+1).
5. Kur në mbledhjen e parë, nuk janë të pranishëm shumica e anëtarëve, kryetari vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër, të paktën 24 orë pas mbledhjes së parë.
6. Në mbledhje merr pjesë pa të drejtë vote edhe specialisti që mbulon strehimin në strukturën përgjegjëse të strehimit në bashki, i cili kryen rolin e sekretariatit teknik.

Neni 7

Marrja e vendimeve

1. Komisioni i Strehimit mere vendime për çështje të cilat janë në rendin e ditës, përveç rasteve kur të paktën 2/3 e anëtarëve vendosin për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve edhe për çështje që nuk janë në rendin e ditës.
2. Komisioni merr vendime me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm.

Neni 8

Procesverbali i mbledhjes

1. Në çdo mbledhje mbahet nje procesverbal, ku të pasqyrohet data, orari i mbledhjes, vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, si dhe forma dhe rezultati i votimeve.
2. Procesverbali mbahet nga sekretari dhe duhet t'u paraqitet për miratim të gjithë anëtarëve në fund të mbledhjes ose në fillim te mbledhjes pasardhëse. Pas miratimit nga anëtarët, procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm.

Neni 9

Detyrat e komisionit të Strehimit

Komisioni ka keto detyra:

1. Komisioni shqyrton brenda 5 ditëve, materialin e paraqitur nga struktura përgjegjëse e strehimit që përmban listën e aplikuesve të klasifikuar sipas sistemit të pikëzimit dhe dokumentacionin përkatës të çdo aplikimi për çdo program të strehimit social, që zbatohet në bashki në përputhje me kriteret e përcaktuara në dispozitat ligjore.
2. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikimeve dhe dokumentacionit përkatës për çdo program të strehimit social, komisioni e dërgon listën përfundimtare të aplikuesve dhe dokumentacionin përkatës të shoqëruar me procesverbal pranë strukturës përgjegjëse të shërbimeve sociale dhe strehimit, e cila e dërgon brenda 3 ditëve për miratim pranë këshilli bashkiak.
3. Për procedurën e subvencionit të qirasë së banesave në pronësi të pronarit social komisioni ka keto detyra:
 - a. Brenda një muaji nga data e miratimit nga komisioni i strehimit të listës së individëve/familjeve që përfitojnë nga subvencionimi i qirasë së banesave në treg të lirë, subjekti përfitues deponon pranë komisionit të strehimit kontratat e qirasë të lidhura ndërmjet tij dhe pronarit social.

b. Në rastet kur subjekti përfitues nuk e depoziton kontratën brenda afatit 1-mujor, komisioni shtyn afatin me 30 ditë. Nëse edhe pas këtij afati shtesë subjekti përfitues nuk depoziton kontratën, ai humbet të drejtën për të vijuar procedurën. Subjekti ka të drejtë të aplikojë përsëri në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë ligj.

c. Pas depozitimit të kontratave të qirave të subjekteve përfituese, përcillen për miratim nga këshilli bashkiak lista dhe kontratat e qirasë. me qëllim që ai të vendosë miratimin e vlerave konkrete të subvencionit të qirasë për çdo përfitues.

Neni 10

Njohja me Rregulloren

Kryetari i Komisionit dhe anëtarët e tij njihen me këtë rregullore dhe sigurojnë të gjitha kushtet dhe mjetet e nevojshme për zhvillimin normal të veprimtarisë së komisionit.

Mosnjohja e rregullores së Komisionit të Strehimit nuk justifikon anëtarin e komisionit nga përgjegjësia.

Neni 11

Hyrja ne fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë me miratimin e saj nga Kryetari i Bashkisë.